



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 532/5 Prot.

Tiranë, më 02.06.2025

V E N D I M

Nr. 135, Datë 02.06.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 75, datë 28.03.2025¹, e bërë nga Partia “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian”, në cilësinë si përfaqësuese dhe mbrojtëse e të drejtave të komunitetit maqedonas, kundër z. Gj.L, aksioner/ortak i Shoqërisë “Rozafa”² shpk, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “etnisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, dhe me email-in datë 06.04.2025, z. V.S, në cilësinë si Kryetar i Partisë “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian”, në mes të tjerash informon se: “Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian (AMIE), si përfaqësuesja e vetme politike e komunitetit maqedonas në Shqipëri, shpreh shqetësimin e saj të thellë dhe proteston ashpër për etiketimin e komunitetit maqedonas në Shqipëri si “shula” nga ana e biznesmenit z. Gj.L, pronar i Shoqërisë “Rozafa” shpk.

Në videon e tij të postuar në faqen facebook të “Rozafa Fish City”³, në datë 05.03.2025, e cila është transmetuar në shumë portale, media dhe gazeta⁴, si Shqiptarja.com, Report TV, Gazeta

¹ Ankesa është plotësuar me email-in datë 06.04.2025.

² NUIS: K48130547V

³ <https://www.facebook.com/FISH.CITY.ROZAFI/videos/422731450899390>; min 3.40

Tema, CNA.AL dhe prapaskena.com, është shprehur: “Partia Aleanca e Maqedonasve, janë mirë këto shulat, po ç’doni ju mor shula me doktorin. O shula po ç’doni mor andej, do na merrni në qafë”, i cili ka cilësuar pakicën kombëtare maqedonase me një terminologji që jo vetëm është e papranueshme, por dhe fyese për identitetin dhe integritetin e këtij komuniteti autokton.

Termi “shula” ose “shule” është një shprehje ofenduese me konotacion pezhorativ që përdoret ndaj pjesëtarëve të komunitetit maqedonas. Ky term perceptohet si fytes dhe përçmues, dhe përdorimi i tij shkakton ndjenja të thella indinjate tek Maqedonasit në Shqipëri.

Në rastin konkret, përdorimi i kësaj shprehjeje nga z. Gj.L – një figurë publike – në faqen zyrtare të “Rozafa Fish City” është transmetuar gjerësisht në media dhe portale të ndryshme, duke shkaktuar reagime të forta në opinionin publik, sidomos tek komuniteti maqedonas. Si reagim ndaj kësaj fjale fyese, pjesëtarët e komunitetit maqedonas janë drejtuar te partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European (AMIE).

Z. Gj.L e ka përdorur këtë term edhe në të kaluarën. Si provë, po ju përcjellim një video nga vizita e tij në Pustec, një vit më parë, e cila është publikuar në kanalën zyrtar të “Rozafa Fish City” në YouTube⁴. Në këtë video, vetë banorët e zonës kundërshtojnë përdorimin e termit “shula” dhe deklarohen qartë si Maqedonas, duke theksuar se një shprehje e tillë është e papranueshme”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe që z. Gj.L të kërkojë ndjesë publike, në faqen facebook të “Rozafa Fish City”, për përdorimin e këtij termi që fyen komunitetin maqedonas.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “etnisë” duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë

⁴ <https://shqiptarja.com/lajm/cuditet-gj.l-tre-dite-ika-nga-shqiperia-dhe-u-be-nami-doktori-paska-bere-nje-super-koalicion-te-madh-qe-do-derdhet-rruges>

<https://report-tv.al/lajm/cuditet-gj.l-tre-dite-ika-nga-shqiperia-dhe-u-be-nami-doktori-paska-bere-nje-super-koalicion-te-madh-qe-do-derdhet-rruges>

<https://www.youtube.com/watch?v=VoyBhLtH1yw>

⁵ <https://www.youtube.com/watch?v=nD4gBuw9A8E>

dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7, i LMD-së, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre”.*

Partia *“Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”*, është regjistruar, në bazë të vendimit nr. 3669, datë 08.06.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Qëllimi dhe objektivat e kësaj partie, ndër të tjera janë:

- mbrojtja e të drejtave dhe interesave politike të popullit maqedonas të Shqipërisë;
- respektimi i të drejtave themelore të njeriut, të drejtave të popullit maqedonas në Shqipëri si dhe të minoriteteve të tjera që jetojnë në Republikën e Shqipërisë;
- dhënia e kontributit të saj për një zhvillim normal të ssoqërisë multi-etnike dhe multi-kulturore shqiptare për të vendosur shtetin e së drejtës dhe ligjit;

Pala ankuese pretendon për diskriminim të personave që janë pjesë e pakicës kombëtare Maqedonase në Shqipëri, nëpërmjet etiketimit të këtij komuniteti si “shula” nga ana e biznesmenit z. Gj.L, në videon e postuar në faqen facebook të “Rozafa Fish City”, në datë 05.03.2025.

Bazuar në LMD, pala ankuese/Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Evropian, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresat nr. 532/2, datë 14.04.2025 dhe nr. 532/3, datë 21.05.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga z. Gj.L, lidhur me pretendimin e palës ankuese.

Me e-mail datë 28.05.2021, z. V.S, Kryetar i Partisë “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian” ka informuar se: “.... ju njoftojmë se z. Gj.L na kontaktoi dhe kërkoi ndjesë për shprehjen e përdorur ndaj komunitetit maqedonas. Gjithashtu, në faqen zyrtare të Rozafa Fish City⁶ u publikua një video-mesazh drejtuar komunitetit maqedonas.

Në këto rrethana, ju informojmë se Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian është tërhequr nga ankesa ndaj z. Gj.L”.

Në video mesazhin e publikuar në faqen facebook të Rozafa Fish City, në datë 24.05.2025, z. Gj.L, në mes të tjerash shprehet se: “Unë e dua komunitetin maqedonas siç dua të gjitha komunitetet që jetojnë në harmoni mes tyre në Shqipëri. Mes fjalëve të mia ka vetëm respekt ashtu siç ka edhe ironi dhe simbolikë miqësore. Shqipëria madhështore nuk kuptohet pa ngjyrat e të gjitha komuniteteve fetare, etnike dhe mike.”.

Në kuadër të ushtrimit të attributeve që i jepen prej Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, si dhe përmbushjes së qëllimit të këtij ligji, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka trajtuar edhe raste të tjera të gjuhës së urrejtjes nga persona publik.

Gjatë aktivitetit të tij, Komisioneri ka dënuar fuqimisht përdorimin e shprehjeve fyese dhe intolerancës ndaj një komuniteti të caktuar, nga ana e individëve që bëjnë pjesë në jetën publike. Gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, si masë rregulluese ndjesë publike në mënyrë që situata diskriminuese e pretenduar të marrë zgjidhjen e duhur e të mos përsëritet më në të ardhmen⁷.

Për sa më lart, në kushtet kur subjekti ndaj të cilit ka nisur procedura hetimore ka reaguar duke kërkuar ndjesë publike në rrjetin social (facebook Rozafa Fish City), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se situata është rregulluar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim, në drejtim të shprehjes së përdorur ndaj anëtarëve të komunitetit maqedonas.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme,

⁶ <https://www.facebook.com/search/top?q=rozafa%20fish%20city>

⁷ Referuar Vendimeve nr. 66, datë 23.04.2021 dhe nr. 221, datë 16.11.2021, të Komisionerit.

Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe nenet 32 e 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 75, datë 28.03.2025, të Partisë “Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European”, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA